



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 710/1 Prot.

Tiranë, më 14 . 04 .2026

V E N D I M

Nr. 81 , Datë 14 . 04 . 2026

Bazuar në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është regjistruar ankesa nr.109 Regj., datë 06.05.2025, e znj. S. M, kundër: Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësve, pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrit të Drejtësisë, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “*bindjeve politike*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Referuar parashtrimeve dhe dokumentacionit të depozituar, subjekti ankues pretendon për diskriminim për shkaqe politike nga ana e Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësve, pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrit të Drejtësisë, të cilët kanë refuzuar dhënien e licencës së ndërmjetësit, duke i mohuar ushtrimin e profesionit dhe duke cenuar parimin e barazisë para ligjit dhe të drejtën për të zgjedhur profesionin dhe fitimin e mjeteve të jetesës me punë të ligjshme.

Subjekti ankues ka parashtruar problematikën e lindur mes saj dhe Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësve, pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrit të Drejtësisë, e cila paraqitet në mënyrë të detajuar dhe e plotë si vijon:

“ Unë, kërkuesja, S. M, kam përfunduar me sukses programin e trajnimit dhe të formimit fillestar profesional për ndërmjetës, të miratuar nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësimit, për periudhën 21 shtator -17 Tetor 2015, për të cilën jam pajisur dhe me certifikatë përkatëse në ceremoninë e

dorëzimit të certifikatave me 17 nëntor 2015, referuar Certifikatës për “Trajnim Fillestar për Ndërmjetës”, lëshuar nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësimit me nr 003 prot dt 12 Nëntor 2015.

Paraprkisht sqaroj se bashkangjitur Ankimit, ju vë në dispozicion CV time, ku pasqyrohet ecuria ime Akademike dhe profesionale ndër vite, duke filluar që nga viti 2003, ku kam përfunduar me sukses Fakultetin e Drejtësisë në Shkodër dhe në vazhdim, duke u zhvilluar vazhdimisht në aspektin pasuniversitar dhe atë profesionale, duke qenë pjesëmarrëse e Konferencave Shkencore Kombëtare, Nderkombëtare, autore e disa artikujve shkencore, pjesëmarrëse në shumë trajnime, etj.

Përsa më lart, rezulton se me datë 15 Dhjetor të vitit 2015 kam përgatitur dosjen dhe terësinë e dokumentacionit sipas ligjit (të noterizuar) dhe i kam dorëzuar në Zyrën e Protokollit, kati -1-rë, pranë Ministrisë së Drejtësisë Tiranë (sqaroj se dorëzimi ka qenë dorazi) dhe që nga ajo periudhë e gjer në vitin 2022, nuk më është kthyer asnjë përgjigje nga ana e Ministrisë, Komisionit të Licencave.

Ndodhur në këto kushte, në shtator të vitit 2022, i jam drejtuar sërish me shkresë Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësimit (ku kjo e fundit më ka sqaruar se për një periudhë kohore procesi ka qenë i bllokuar) porse u vura në dijeni se nuk gjindet asgjëkundi dosja ime).

Sqaroj se gjatë kësaj kohe u vura njëkohësisht në dijeni nga ana e kolegëve të mi, se procedurat për licencim vijnë, fakt për të cilin të gjithë kolegët e grupit që kanë përfunduar trajnimin me mua (apo pas meje) ishin pajisur me licencë.

E ndodhur në këto kushte, i jam drejtuar sërish me shkresë në shtator të vitit 2022 (fakt i vertetuar me anë të shkresës me nr. 01 prot/2022 ku i kam kërkuar pajisjen me licencë sipas ligjit, duke i vënë në dispozicion të gjithë dokumentacionin shkresor përkatës, si dhe kopje te ekstraktit duke i pasqyruar faktin se tashmë isha person fizik, duke treguar vendosmërinë time për të proceduar me profesionin e ndërmjetësit përcese atij të Avokatit.

Jam paraqitur disa herë personalisht pranë Ministrisë së Drejtësisë, duke kërkuar takim me Ministrin, apo me përfaqësues të Zyrës së Komisionit të Licencimit, porse tek Protokollit pasi më kanë marrur të dhënat, kartën e ID, dhe lënë në pritje, më kanë thënë që do ju kontaktojmë personalisht, pasi është në proces... e njëjta procedure ka vazhduar për një vit, porse pa sukses.

Me datë 30.01.2025, jam vënë në dijeni të shkresës me nr. S-199/1 prot dt 28.01.2025 lëshuar nga Drejtoria e Monitorimit të Profesioneve të Lira Sektori përkatës), me objekt “Kthim Përgjigje” të shkresës me nr. S-199-Prot dt 13.11.2024 të dërguar nga ana ime, me anë të së cilës kanë bashkangjitur shkresat dhe praktikën shkresore për moslicencim si Ndërmjetës.

Sipas verifikimeve të kryera pranë Ministrisë së Drejtësisë, rezulton se me shkresën Nr. S-165/1 dt 07.06.2023, jam njoftuar për refuzimin e kërkesës sime të paraqitur pranë Komisionit të Licencimit, ku dhe Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësimit është në dijeni.

Bashkangjitur kësaj praktike është dhe shkresa Nr. S -165/1Prot dt 07.06.2023 drejtuar S. M (me adresë Rruga Brigada 8, Pallati Tekno Projekt, Kati 4, AP.13, Tiranë, me nr 067862498) si dhe Dhomës Kombetare të Ndërmjetësive me të njëjtën adresë (me adresë Rruga Brigada 8, Pallati Tekno Projekt, Kati 4, AP.13, Tiranë).

Bashkangjitur shkresës me Nr. S -165/1Prot dt 07.06.2023, është dhe vendimi Nr.2023-273-dt 02.06.2023 “Për refuzimin e dhënies së Licencës së Ndërmjetësit “për arsye se dokumentacioni duhet të jetë i noterizuar, dhe se kundër këtij vendimi duhet të procedohet me Ankim brenda 10 ditëve nga marrja dijeni pranë Ministrinë të Drejtësisë.

Ndodhur në këto kushte nga ana e jonë është proceduar më Ankim sipas ligjit dhe duke i vënë në dijeni si Komisionin e Licencimit të Ndërmjetësive dhe Ministrinë e Drejtësisë se vendimarrja ishte e pabazuar në ligj dhe se unë nuk jam njoftuar sipas ligjit, duke parashtruar si më poshtë citohet:

Nuk rezulton që unë të jem vënë në dijeni të shkresës me Nr. S-165/1 prot dt 07.06.2023, lidhur me refuzimin e kërkesës sime, bashkangjitur, Njoftim Vendimi me nr S-165/1 prot dt 07-06-2023 dhe Vendimi i Refuzimit me nr 2023-273, dt 02.06.2023, pasi ka mospërputhje adresash dhe ky njoftim nuk është dorezuar asnjëherë në ambientet e zyrës sime.

Siç citohet në njoftim dhe tek korrespondenca shkresore e dërguar nga ana e KLN, adresa përkatëse ku është dërguar njoftimi, rezulton të jetë, Rruga Brigada 8”, Pallati Tekno Projekt, Kati 4, Ap.13, Telefon 0697862498. Ndërkohë në periudhën e dërgimit të shkresës së sipërcituar, adresa ime nuk rezulton ajo e pasqyruar në Njoftim, fakt i vertetuar me anë të ekstraktit historik, bashkangjitur këtij Ankimi.

Përsa më lart, sipas ekstraktit historik rezulton se me dt 30/09/2022 Numri i çështjes: CN-005259-09-22 Arsyet e hapjes së çështjes: Ndryshim adrese kryesore. Kanë ndodhur ndryshime në adresat e aktivitetit, kështuqë konstatohet qartazi se në periudhën e dërgimit të shkresës së sipërcituar, unë kam pasur adresë tjetër.

Nuk rezulton që të jem njoftuar për shkresën as në rrugë postare, as me anë të celularit, apo emailit, të dhëna këto që kanë qenë të pasqyruara në shkresën time, Cv, si dhe ekstraktin historik bashkangjitur shkresës të dërguar nga ana ime.

Pretendimi për mosparaqitje të dokumentacionit të noterizuar është pjesërisht i pasaktë, pasi shkresa e dërguar nga ana e ime datë 13.11.2024, është në kuadër të korrespondencës shkresore të mëparshme, (2015/2022) ku dokumentacioni i paraqitur fillimisht (2015) ka qenë i noterizuar dhe

në formën e parashikuar nga ligji, ndërkohë praktika e paraqitur në 2022 ka qenë fotokopje pasi siç kam sqaruar e kam depozituar dhe një herë dokumentacion të noterizuar në 2015.

Përsa më lart, nqs problematika në vitin 2022, ka qenë noterizimi i dokumentacionit përkatës, prezumoj se do ishte e udhës të më lihej një afat kohor për “Plotësimin e kësaj të metë”, e cila prezumoj se nuk mund të përbëjë shkak aq madhor sa për të proceduar me refuzim të dhënies së licencës, pasi çmuj se kjo është e metë formale që rregullohet brenda ditës.

Në kuadër të ushtrimit të drejtës së Ankimit, bazuar në pikën 2 të Vendimit Nr 2023-273, datë 02.06.2023, kam ushtruar të drejtë ankimi, brenda afatit ligjor për ankim, 10 ditë nga marrja dijani (rezulton se dijani kam marrur më 30.01.2025)

Bashkangjitur Ankimit tim, kam depozituar kopje të noterizuar të terësisë së dokumentacionit të paraqitur referuar Vertetim i Njësisë me Originalin me nr. Rep 355 dt 31.01.2025, rezultojnë të noterizuara dokumentat si: Diplome Jurist -Nr. 352, bashkangjitur Listë Notash, lëshuar nga Universiteti Luigj Gurakuqi -Shkodër, dt. 05.07.2003. Certifikatë “Avokat”, lëshuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatëve-Tiranë, dt 04.12.2024. Diplomë Master në Shkencat Publike, lëshuar nga Universiteti i Tiranës, 2006-2009. Diplome Bachelor në Psikologji, lëshuar nga Universiteti i Tiranës në 10.09.2014. Certifikatë, Trajnim Fillestar për Ndërmjetës 12 nëntor 2015. Certifikata Trajnime (11 certifikata). Certifikata Pjesmarrje (17 certifikata), duke theksuar faktin se referuar Cv time, bashkangjitur shkresës së fundit dt 2022, rezulton se jam autore e disa artikujve shkencore, dhe pjesmarrje në konferenca shkencore, Kombëtare dhe Ndërkombëtare.

Që nga data e bërjes së ankimit datë 31.01.2025 e gjer më sot 05.05.2025, nuk më rezulton të më jetë kthyer përgjigje lidhur me kërkesën ankimore.

Sqaroj se kam vajtur vazhdimisht të interesohem pranë Ministrisë së Drejtësisë për vendimarrjen si dhe takim por tek hollit i Ministrisë, vazhdimisht më është thënë që do ju kthejmë përgjigje, në rrugë shkresore dhe se Ministri nuk do të takojë.

Përsa më lart, ndodhur në kushtet kur jam në pamundësi për të marrë një vendim dhe duke mos dashur të kalojë dhe një dekadë tjetër për kthim përgjigje, jam e detyruar të bëj këtë kërkesë ankimore pasi ndihem e diskriminuar nga Shteti im i cili jo vetëm të largon nga puna kur je, nuk të lejon të futesh në punë në administratë shtetërore (pavarësisht cv) por mbi të gjitha dhe kur tenton të jesh i vetpunësuar, të pamundëson ushtrimin e profesionit të lire në kushte të barabarta me të tjerë.

Çmuj se arsyeja ne diskriminimit tim, është në kuadër të shfaqjeve dhe bindjeve të mia të cilat bien ndesh me linjën e “Qeverisë akuale”, ku shfaq mendimin tim lidhur me: korrupsionin që ka pushtuar vendin , pastrimin e lekeve, shtrenjtësinë e shportës ushqimore, pastrimin e lekeve përmes ndërtimeve si rrjedhojë e së cilës jemi ndër vendet me të ardhura më të vogla por me çmimet më të

shtrenjta, mungesën e kushteve spitalore, pensionet e vogla, mungesën e KEMPEVE apo ndihmën ekonomike për gratë e divorcuara me fëmijë, ndërtimin e rrugëve të shtrenjta, abuzime në tendera, dështimin e arsimit, shëndetësisë, apo drejtësisë, zvarritjen e çështjeve të pronave, si dhe dështimin e hartës së re gjyqësore e cila zvarrit pambarimisht shtetasit, ku më parë vdesin se fitojnë një të drejtë gjyqësisht, politikën shpopulluse të shqiptarëve, varfërimin, mjerimin e tyre.

Këto bindje, mendime i shfaq haptazi përmes shkrimeve të mia publike, apo ftesave në studio, apo protestave paqësore ku dhe kam folur lidhur me cënimin e të drejtave të shqiptarëve.

Çmuj, pretendoj, dhe gjykoj se arsyeja e diskriminimit tim është pikërisht për shfaqjen haptazi të mendimeve të mia, në një vend, ku administrata shtetërore është e kufizuar të bëjë like, koment në rrjete sociale pasi hiqet nga puna.

Sqaroj se referuar CV -së time, eksperiencës profesionale, që nga viti 2004 dhe aktualisht, jam e aftë dhe kam dhënë prova për kryerjen jo vetëm të profesionit të juristit, avokatit, por dhe të ndërmjetësit nisur nga fakti se si procedurë e kam ndjekur gjatë eksperiencës sime profesionale në studio ligjore).

Konstatohet pabarazi në dhënien e licencës mes meje që jam minimalisht, juriste dhe pastaj tituj të tjerë në raport me kolegë të tjerë ku janë dhënë licencat, pavarësisht faktit që mund të mos jenë as juristë, por kanë kryer studime që nuk i përkasin profesionit të juristit.

Konstatohet pabarazi në dhënien e licencës mes meje që dua të ushtroj si profesion dhe kolegëve të tjerë të cilët kanë qenë të punësuar në Shtet apo janë dhe janë të pajisur me licencë Ndermjetësi, si rrjedhojë e pozicioneve të tyre, përse jo, njohjeve etj....

Konstatohet pabarazi lidhur me lënien në heshtje për thuarje një dekadë lidhur me dhënien e një përgjigjeje, apo mungesën e dhënies së vendimi nga ana e Ministrisë, e përse jo dhe refuzimit për takim.

Konstatohet pabarazi pasi kam kërkuar takim pranë Ministrisë, Komisionit të Licencave, por askush nuk më ka telefonuar, njoftuar, për të më dhënë mundësinë e takimit, të degjuarit, e aq më pak mundësinë e të "vetpunësuarit"

E kuptoj që si rrjedhojë e qëndrimeve të mia të diskriminohem duke mos më bërë pjesë përbërëse të administratës shtetërore, se nuk jam ushtar, apo se kam guxim të trumpetoj të vërtetën, por se kuptoj përse më mohojnë të drejtën për vetpunësim, rritje biznesi, zgjerim të biznesit tim, duke më mohuar të drejtën për fitimin e mjeteve të jetesës me punë të ligjshme sipas Kushtetutës dhe Konventës Europiane e të Drejtave të Njeriut.

Çmuj se mungesa e dhënies së licencës, mostrajtimi në mënyrë të barabartë me të tjerët, që kanë përfunduar paralelisht me mua, apo pas meje, përbën diskriminim kundrejt meje, e normalisht,

mungesa e dokumentacionit të noterizuar nuk përbën shkak, pasi ekzistenca e dokumentacionit ligjor, vertetohet përmes titujve që una kam, jurist, avokat, person fizik (minimalisht).

Duke qenë në këto kushte, kërkoj që të konstatohet diskriminimi, si rrjedhojë e veprimeve dhe mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, shkeljen e afateve ligjore, etj. Komisionit të Licencave dhe Ministrisë të Drejtësisë.

Çmujmë se kërkesa jonë është e bazuar në prova dhe në ligj për arsyet që po parashtrijmë si më poshtë vijon:

Sqaroj se procedura e filluar nga ana e ime është që në vitin 2015 e përsëritur në vitin 2022 dhe vendimarrja e refuzimit që i përket vitit 2023 më është komunikuar në vitin 2025.... ndërkohë nga ana e Ministrisë nuk është proceduar me vendimarrje (pranim apo refuzim). Procedura e ndjekur nga Komisioni, që nga ana e ime nuk janë paraqitur dokumenta të noterizuar është jo vetëm abuziv por dhe në kundërshtim me ligjin dhe abuziv... pasi unë kam aplikuar si Avokate për nxjerrjen e licencës së Ndërmjetësit. Kjo do të thotë që minimalisht unë disponoj:

- Diplomë si Jurist, Diplomë si Avokat, Certifikatën e Trajnimit si Ndërmjetës, Licencë Avokati, Certifikatë Regjistrimi si Përsone Fizik, ku pasqyrohet fakti që ushtroj një aktivitet e për rrjedhojë i paguaj Shtetit, taksa, tatime dhe cdo detyrim ligjor.
- Përveç kësaj kam paraqitur dhe diploma, trajnime, të tjera të cilat pasqyrojnë kualifikimet e mia pasuniversitare dhe eksperiencën e punës pasqyruar në CV).

Sqaroj se minimalisht nga ana e ime janë paraqitur disa kërkesa, ankesa por mbi të gjitha dokumentacioni i noterizuar është paraqitur në 2015... në Komisioni ka dashur t'i paraqesë dokumentacion të noterizuar, a nuk ka pasur mundësi të më vërë në dijeni?

Nga shtatori i vitit 2022 deri në vendimarrjen e tyre në qershor të vitit 2023, është një kohë e mjaftueshme e lënë në dispozicion Komisionit për Vendimarrje, por në kuadër të parimeve të barazisë, ligjshmërisë, informimit, mund të më jepnin dhe mua 1 (një) ditë kohë pune për noterizim dokumentash. Sqaroj se kërkesa ime është e ripërsëritur që nga viti 2015.

Nga ana e Komisionit nuk jam vënë në dijeni asnjëherë për vendim refuzimi, pasi siç konstatohet qartazi, adresa e ushtrimit të aktivitetit tim, nuk përputhet me adresën e dergimit të njoftimit. Njëkohësisht sqaroj se nuk jam njoftuar as nga DHKN, për këtë vendimarrje. Disa herë kam vajtur në ambiente për të kërkuar informacion por se nuk jam vënë në dijeni të ndonjë vendimarrje refuzimit. Theksoj sërish faktin se nga ana ime janë vënë në dispozicion të dhëna që lidhen me ushtrimin e aktivitetit tim, Nr Nipti, Adrese, numer celulari, adrese emaili, të gjitha këto që janë publike...Mosnjoftimi në adresat respektive përbën mospërbushje detyre nga ana e tyre.

Konstatoj cenim të së drejtës time dhe nga ana e mosmarrjes se një vendimi nga ana e Ministrisë, i cili duhet të shprehet lidhur me Ankimin tim. Sa dekada duhet të pres për marrjen e një licence....

A mos vallë duhet dhe unë të braktis vendin tim, pasi nuk më jep asnjë mundësi ...dhe më diskriminon në çdo hap, duke më mohuar të drejtat e mia, duke i vonuar, apo duke i mos dhënë ato???

Sqaroj se mosdhënia e licencës cenon të drejtën tim për biznes, pasi tashmë unë kam hapur një aktivitet, paguaj taksa, tatime, qera, sigurime shoqërore, dhe cdo detyrim sipas shtetit, duke e qenë e rregullt dhe duke i përmbushur detyrimet e mia ligjore., ndaj me të drejtë lind pyetja.... Përse Shteti mua më kufizon? Cila është arsyeja e vërtetë e mosdhënies se Licencës së Ndërmjetësit minimalisht që nga 2022, vit në të cilin kam hapur dhe aktivitetin si person fizik “Avokat”.

Përfundimisht, përsa më lart citohet, pretendojmë se ndaj meje, kërkueses, është proceduar në kundërshtim me ligjin duke qenë viktimë e diskriminimit nga ana e Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësve, pranë Minisitrisë së Drejtësisë-Tiranë. Ministri Drejtësisë, për arsye politike apo çdo lloj arsyeje tjetër, por që si pasojë e të cilës më janë cenuar të drejtat e mia në mënyrë të kundraligjshme.”.

Subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi: “Konstatimin e diskriminimit për arsye politike, apo çdo shkak tjetër nga ana e Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësve, pranë Minisitrisë së Drejtësisë dhe Ministrin të Drejtësisë, si rrjedhojë e refuzimit të dhënies së licencës, mosnjohimit në kohë dhe mosdhënies së vendimit përfundimtar ndaj Ankimit në rrugë Administrative, që përbën shkelje të së drejtës për informacion, përfitim licence sipas ligjit nga ana e ime, ushtrim profesioni, duke cenuar parimin e barazisë përpara ligjit, dhe të drejtës për të zgjedhur profesionin dhe fitimin e mjeteve të jetesës me punë të ligjshme.”.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një

trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Pas analizimit paraprak të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me anë të shkresës me nr. 741/1 prot., datë 20.05.2025, ka kërkuar nga ana e: Ministrisë së Drejtësisë dhe Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësve, pranë Ministrisë së Drejtësisë, informacionin dhe dokumentacionin si vijon:
 - *“Parashtrime dhe shpjegime, lidhur me secilin nga pretendimet e subjektit ankues.*
 - *Kopje të Rregullores së Brendshme të Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësve, nëse ka një të tillë.*
 - *Cilat janë arsyet e mosmiratimit apo refuzimit të dhënies së Licencës së Ndërmjetësit për subjektin ankues? Parashtrimet tuaja.*
 - *Sa persona kanë aplikuar për marrjen e Licencës së Ndërmjetësit, në të njëjtën periudhë kohore me ankuesen?*
 - *Sa personave u është miratuar/dhënë Licenca dhe sa personave jo? Të citohen rastet specifike dhe arsyet lidhur me secilin rast (shoqëruar me dokumentacionin shkresor përkatës).*
 - *Cilat janë aktet ligjore/nënligjore që përcaktojnë procedurën që ndiqet për miratimin e dhënies së lejes së Licencës së Ndërmjetësit dhe praktika që ndiqet nga Komisioni i Licencimit të Ndërmjetësve?*
 - *Cila është procedura e ndjekur në rastin konkret për ankuesen, znj. S. M? Kopje e saj.*
 - *Kopje të praktikave apo procedurave të ndjekura nga ana e juaj lidhur me raste të njëjta apo të ngjashme me të subjektit ankues, nëse ka të tilla.*
 - *Informacion nëse znj. M është ankuar shkresërisht (në rrugë administrative) apo ka pretenduar diskriminim nga ana e Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësve dhe Ministrisë së Drejtësisë. Nëse po, një kopje të praktikës shkresore së mbajtur me znj. M.*
 - *Informacion nëse ankuesja ka kundërshtuar gjyqësisht veprimet e pretenduara nga ana e subjekteve sipërcituar. Nëse po, një kopje të aktit. (kërkesë padisë).*
 - *Çdo informacion tjetër që ju do e gjykoni të arsyeshëm se do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.”*

2. Nëpërmjet shkresës me nr. 2666/1 prot., datë 30.05.2025, Ministria e Drejtësisë, ka dërguar pranë KMD-së, parashtrimet përkatëse, duke cituar ndër të tjera se:

- “MD, lidhur me subjektin ankues, ju informon se:
- Znj. S. M ka aplikuar në MD, me shkresën me nr. S-284 prot., datë 26.09.2022, me lëndë: “Pajisje me Licencë Ndërmjetësimi”.
- Në aplikimin e saj, subjekti ankues ka bashkëlidhur gjithë dokumentacionin në fotokopje.
- Në aplikimin e saj, subjektit ankues i mungon gjithë dokumentacioni sipas parashikimeve të VKM nr. 414, datë 08.06.2011 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësve”, përveç jetëshkrimit, dokumentacion ky i dërguar me aplikimin nr. S-284 prot., datë 26.09.2022.
- Në këtë aplikim znj. S. M, ka si adresë dërguese: “L. “Haxhi Hysni Dalliu”, Nd. 8, H. 2, Ap. 10, Njësia Bashkiake nr. 9, Tiranë, ndërsa, në aplikimin e znj. M, në kokën/hyrjen e aplikimit, rezulton: “Subjekti ushtron aktiviteton në adresën: Rruga “Brigada e 8”, Pll. Teknoprojekt, K. 4, Ap. 13, Njësia Administrative nr. 5, Tiranë.

Në ligjin nr. 10385, datë 24.02.2011 “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”, të ndryshuar, është parashikuar se:

Dispozitë kalimtare (e vendosur me ligjin nr. 26/2018, datë 17.5.2018)

1. Kërkesat për licencim, që janë paraqitur pranë Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësve përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, trajtohen sipas dispozitave në fuqi të ligjit, në kohën e paraqitjes së kërkesës.

2. Komisioni i Licencimit të Ndërmjetësve përfundon veprimtarinë e tij me përfundimin e shqyrtimit të kërkesave të cituara në pikën 1 të këtij neni.

Ndërkohë në VKM nr. 414, datë 08.06.2011 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësve”, është përcaktuar në mënyrë të hollësishme procedura e licencimit, krijimi dhe mënyra e organizimit e funksionimit të Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësve.

Në pjesën III, pika 3, janë përcaktuar dokumentet e nevojshme që duhen paraqitur nga personi fizik, për licencim:

Kërkesa plotësohet sipas formularit tip, i propozuar nga kryetari dhe i miratuar nga komisioni. Ajo shoqërohet me dokumentet përkatëse, të cilat vërtetojnë përmbushjen e kushteve për ndërmjetës, të parashikuara në ligj, dhe depozitohet pranë komisionit.

3. Dokumentet e nevojshme që duhet të paraqiten nga personi fizik janë këto:

- a) formulari tip, i plotësuar me të gjitha të dhënat e sakta të kërkuara;
- b) jetëshkrimi;

- c) një dokument që vërteton identitetin e nënshkruesit dhe faktin nëse është personi i autorizuar për të paraqitur kërkesën (pasaportë apo letërnjoftim);
- ç) një referencë ose rekomandim nga punëdhënësi i mëparshëm ose ai aktual;
- d) diploma e noterizuar, për përfundimin e studimeve të ciklit të parë, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë;
- dh) formulari i plotësuar i vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore;
- e) vërtetimi i përfundimit të programit të trajnimit dhe të formimit profesional të ndërmjetësve, i miratuar nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësimit;
- ë) një dokument që provon pagesën e tarifës së dhënies së licencës prej 5000 (pesë mijë) lekësh, - nga të cilat, sipas dosjes së aplikueses, ka paraqitur vetëm: b) jetëshkrimin dhe e) vërtetim të programit të trajnimit dhe formimit profesional të ndërmjetësve, i miratuar nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve (fotokopje). Dokumentet e tjera mungojnë.

Në datën 02.06.2023, Komisioni i Licencimit të Ndërmjetësve, me Vendimin nr. 2023-273, datë 02.06.2023 “Për refuzimin e dhënies së Licencës së Ndërmjetësimit”, ka vendosur:

“Refuzimin e kërkesë për dhënien e licencës së ndërmjetësimit znj. S. M, për shkak se nuk përmbush kushtet e parashikuara në pikën 3 dhe 9, të VKM nr. 414, datë 08.06.2022 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësve”, ku parashikohet se dokumentacioni i depozituar nga na e kërkuesit duhet të jetë i noterizuar.

Kundër vendimit të Komisionit mund të bëhet ankim pranë Ministrisë së Drejtësisë brenda 10 (dhjetë) ditësh nga data e njoftimit....”

Sipas VKM, në pjesën IV, pika 7, është përcaktuar se: “...Vendimi i Komisionit i njoftohet kërkuesit me shkrim, pa vonesë. Vendimi i refuzimit përmban, në çdo rast, arsyet e refuzimit të kërkesës për licence.”

Gjithashtu me shkresën me nr. S-165/1 Prot., datë 07.06.2023, me lëndë: “Njoftim vendimi”, Komisioni i Licencimit të Ndërmjetësve, i ka njoftuar znj. M vendimin e refuzimit të Komisionit. Adresa në të cilën është dërguar kjo shkresë, është, adresa në faqen e parë të aplikimit të znj. M.

Nga verifikimi i kryer nga sektori aktual përkatës pranë Ministrisë së Drejtësisë, që monitoron profesionin e ndërmjetësimit si dhe nga verifikimi i kryer në sektorin e Arkiv-Protokollit, rezulton se zarfi me të cilën është dërguar kjo shkresë ka mbërritur në destinacionin e dërguar, pra ka pasur një marrës.

Znj. M pretendon se ka ndryshuar adresën dhe nuk e ka marrë zarfin, pretendim ky që, Minsitria e Drejtësisë nuk ka asnjë informacion dhe asnjë shkresë hyrëse ku të informohet për ndryshimin e adresës së subjektit ankues.

Të ndodhur në kushtet kur shkresa përcjellëse dalëse me refuzimin e vendimit, pra vijimi i komunikimit është në adresën e vendosur nga vetë ankuesja si dhe në kushtet kur s’kemi asnjë

lajmërim për ndryshim adrese, ankuesja nuk mund të pretendojë për moslajmërim të vendimit apo diskriminim për shkaqe politike, pasi asnjë nga pretendimet nuk qëndron.

Komisioni i Licencimit të Ndërmjetësve ka filluar punën me Urdhrin nr. 651, datë 26.11.2021 “Për një ndryshim në Urdhrin nr. 3653, datë 29.03.2018 “Për caktimin e përfaqësuesve të Ministrisë së Drejtësisë në përbërjen e Komisionit për Licencimin e Ndërmjetësve”.

Me hyrjen në fuqi të Urdhrit janë caktuar përfaqësuesit e MD-së, anëtar të Komisionit të Licencimit dhe ka vijuar nga puna sipas VKM-së përkatëse të vitit 2021, punë e organizuar në bazë të mbledhjeve periodike. Ky është momenti kur Komisioni ka filluar punën pas një periudhe të gjatë që procesi i licencimit ka qenë i bllokuar, pra në fund të muajit nëntor 2021, është formuar Komisioni dhe menjëherë ka vijuar puna me shqyrtimin e dosjeve.

Në total Komisioni ka mbajtur 16 mbledhje, të provuara nëpërmjet procesverbalëve përkatës.

Nga mbledhjet e Komisionit të Licencimit rezulton se:

Janë marrë në shqyrtim 277 (dyqind e shtatëdhjetë e shtatë) aplikem, nga të cilat:

- Janë licencuar 253 (dyqind e pesëdhjetë e tre) kandidatë si ndërmjetës të konflikteve gjyqësore;*
- Janë refuzuar 24 (njëzet e katër) kandidatë si ndërmjetës të konflikteve gjyqësore.*

Në përmbledhje, refuzimi për marrjen e licencës si ndërmjetës të konflikteve gjyqësore, për 24 aplikantët ka ndodhur për shkak se:

- Nuk përmbushnin kriteret e përcaktuara në ligj;*
- Kishin mangësi në dokumentacion;*
- Rezultonin të dënuar me vendim gjyqësor;*
- Kishin ndërruar jetë...*

Gjithashtu, në datën 30.05.2025, i është dërguar kërkesë me e-mail Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve, nëse ka informacion për aplikimin e znj. M. Po ashtu, edhe sektorit të Arkiv-Protokollit nëse ka informacion për aplikimin e znj. M të vitit 2015, dhe është kthyer përgjigje që duhet të kontrollohen arkivat dhe nevojitet më tepër kohë. Kështu, menjëherë pas përgjigjes së Arkiv-Protokollit, do ju vendoset në dispozicion edhe përgjigjja konkrete, nëse ka pasur apo jo aplikim tjetër nga ana e znj. M.”

- 3.** Nëpërmjet e-mailit datë 02.07.2025, ankueses i janë përcjellë për njohje parashtrimet dhe dokumentacioni i depozituar nga MD.
- 4.** Pas njohjes me sa më sipër, me shkresën me nr. 423 prot., datë 08.07.2025, subjekti ankues ka depozituar pranë KMD-së prapësimet e saj lidhur qëndrimin e MD-së.
- 5.** Në vijim të procedurës hetimore, për një gjykim sa të drejtë të kësaj çështjeje dhe për të zhvilluar një proces të drejtë ligjor, në zbatim të parimit të kontradiktoritetit, mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të

ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 741/4 prot., datë 25.07.2025, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancë dëgjimore, që do të zhvillohet në datën 28.08.2025, ora 10:00, pranë Zyrës së Komisionerit.

6. Nëpërmjet kërkesës me e-mail (pas komunikimit të sa më sipër), palët kanë kërkuar shtyrjen e seancës për një datë tjetër, pasi për arsye objektive nuk e kishin të mundur pjesëmarrjen me datë 28.08.2025.
7. Pas vlerësimit të kërkesës së tyre, Komisioneri caktoi datën 22.10.2025, ora 12:00, për zhvillimin e seancës dëgjimore, fakt i cili iu komunikua palëve nëpërmjet e-mailit.
8. Seanca nuk u mundësua të zhvillohej për arsye objektive as në këtë datë, fakt i cili u komunikua po nëpërmjet e-mailit. Palëve iu është bërë e ditur, se gjatë seancës kanë të drejtë të depozitojnë në cilësi prove çdo informacion plotësues ose akt administrativ, të cilin ende nuk e kanë paraqitur pranë KMD-së dhe që vlerësojnë se ka rëndësi për përcaktimin e gjendjes së fakteve e rrethanave të çështjes.
9. Seanca u zhvillua më datë 16.12.2025, me praninë e subjektit ankues, znj. M. Nga ana e Ministrisë së Drejtësisë nuk u paraqit asnjë përfaqësues. Ndërkaq, në seancë u paraqit znj. D. A¹, e cila, nuk kishte autorizim përkatës për të përfaqësuar në seancë Komisionin e Licencimit të Ndërmjetësve/MD.

Subjekti ankues deklaroi se u qëndron të gjitha pretendimeve të ngritura në parashtrimet e depozituara pranë KMD-së, duke theksuar, ndër të tjera se: *“Mendoj se Komisioni ka vepruar me udhëzimin e shefit të madh. Ky është një dyshim i imi, nuk kam prova. Për muaj nuk më është dërguar një e-mail që unë të noterizoja dokumentat përpara marrjes së vendimit. Përse Ministri nuk del me një akt lidhur me noterizimit të dokumentit?”*

Komisioneri çmon se, në kushtet kur znj. D. A (as gjatë seancës dhe as pas saj) nuk ka një akt përfaqësimi nga MD, i cili ta autorizonte atë të fliste në emër të Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësve, pranë Ministrisë së Drejtësisë, deklaramet e saj nuk përbëjnë prove, e nuk merren në konsideratë për efekt të shqyrtimit të ankesës.

10. Pas seancës dëgjimore, nëpërmjet shkresës me nr. 12 prot., datë 05.01.2026, Komisioneri iu drejtua sërish Ministrisë së Drejtësisë, ku evidentohet ndër të tjera se:

“Sikurse jeni në dijeni, përmes njoftimit shkresor dhe me e-mail me KMD-në, me datë 16.12.2025, pranë Zyrës së KMD-së është zhvilluar seanca dëgjimore. Seanca është zhvilluar me praninë e subjektit ankues, në mungesën e përfaqësuesit të MD-së dhe me praninë e znj. D. A, në cilësinë e Kryetares së Dhomës së Licencimit të Ndërmjetësve (njëherësh ish-Kryetare e Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësve/MD), pa autorizimin përkatës nga ana e MD-së.

¹ Kryetare e Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve dhe Kryetare e Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësve, në periudhën kohore që ankohet znj. M.

Palët u qëndruan të njëjtave pretendime e parashtrime ai ato të bëra të njohura me komunikimin shkresor KMD-së. Bashkëlidhur për njohje, gjeni një kopje të procesverbalit të mbajtur gjatë seancës.

Në këtë kontekst, pavarësisht faktit se keni dërguar qëndrimin dhe parashtrimet tuaja shkresore pranë Zyrës së KMD-së, Komisioneri, sjell në vëmendje se, nëse keni parashtrime/konkluzione përfundimtare, fakte e prova të tjera shtesë, si subjekti kundër të cilit drejtohet ankesa, t'i depozitoni brenda 10 ditëve pune nga marrja dijani e kësaj shkrese².

Komisioneri kërkon nga ana juaj gjithashtu, të depozitoni si më poshtë vijon:

- Informacion lidhur me pretendimin e ankueses për dorëzimin e dokumentacionit të noterizuar me datë 15 dhjetor 2015. Kopje të akteve bashkëlidhur.
- Informacion çfarë ka ndodhur me aplikimet e bëra gjatë 2015-ës dhe sa të tilla rezultojnë?
- Në cilin vit është iniciuar për herë të parë procedura për dhënien e licencave të ndërmjetësve/MD? Nga viti 2015 deri në vitin 2021 çfarë veprimesh apo procedurash (nëse ka pasur të tilla) janë ndërmarrë nga MD, lidhur me hapjen e zhvillimin e procedurës për dhënien e licencave të ndërmjetësve/MD.”

11. Nëpërmjet shkresës me nr. 2666/4 prot., datë 21.01.2026, Ministria e Drejtësisë, ndër të tjera, informon Komisionerin se:

“...pas kërkimeve në sektorin e Arkiv-Protokollit, rezulton se, pranë Ministrisë së Drejtësisë, nuk ka asnjë kërkesë për licencim si ndërmjetëse nga znj. S. M përgjatë vitit 2015.

Gjithashtu rezulton se, e vetmja kërkesë e znj. M, paraqitur pranë MD-së, mban numër protokollit S-216, datë 14.09.2015, me lëndë: “Kërkesë ankimore për shkarkim të padrejtë nga puna”. Lidhur me këtë ankim, MD, I ka kthyer përgjigje ankueses me shkresën me nr. S-216/3 prot., datë 09.11.2015.

Ndërkohë, lidhur me kërkesën tuaj tjetër për informacion mbi procedurën e dhënies së licencave dhe numrin e aplikimeve gjatë vitit 2015, ju informojmë se:

Ligji nr. 10385, datë 24.02.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, i ndryshuar, ka pësuar ndryshime sa i përket kushteve dhe procedurës së licencimit, fillimisht në vitin 2013 dhe më pas në vitin 2018, duke ndryshuar kompetencat e Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësve mbi licencimin e subjekteve të interesuara në ushtrimin e veprimtarisë së ndërmjetësimit dhe duke shtuar kompetencat e Ministrisë së Drejtësisë si autoriteti licencues, si dhe detyrimin për kryerjen e trajtimit fillestar dhe provimit kualifikues nga ana e kandidatëve për ndërmjetës.

Lidhur me aplikimet e bëra gjatë vitit 2015, si dhe veprimet dhe procedurat e ndërmarrë nga Ministria e Drejtësisë nga viti 2015 deri në vitin 2021, për hapjen e zhvillimin e procedurës për dhënien e

² Neni 33, pika 7 e LMD, të ndryshuar: “Me regjistrimin e ankesës, Komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, Komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 10 ditëve pune nga dita që palët marrin njoftimin”.

licencave të ndërmjetësve, përmbledhja, verifikimi dhe administrimi i këtij informacioni kërkon një kohë më të gjatë nga ana e MD-së, për shkak të nevojës për të konsultuar me strukturat përgjegjëse një sasi e madhe informacioni dhe dokumentacioni.”

12. Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit e transparencës, për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, ankuesja nëpërmjet e-mail-it datë 23.01.2026, është njohur me përgjigjen e Ministrisë së Drejtësisë, por nuk ka depozituar objeksione apo parashtrime të tjera për sa më sipër.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me parashikimet ligjore ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e ankueses, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e saj për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”*.

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij”*.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekteve kundër të cilëve është bërë ankesa të vihen në dijeni për ankesën e bërë dhe u janë ofruar mundësitë që të japin shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktimi e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në *“shkakun e mbrojtur”*.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesja është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke dalluar, përjashtuar apo kufizuar ankuesen në të drejtën e saj për pajisjen me licencën e ndërmjetësuesit;
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesja, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ajo i është nënshtruar ndonjë trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm, lidhur me pajisjen me licencë ndërmjetësimi, në respektim të kërkesave ligjore të parashikuara nga legjislacioni në fuqi lidhur me pajisjen e aplikantëve me licencë ndërmjetësimi.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm.

Për të vlerësuar pretendimin për diskriminim për shkakun e pretenduar, të parashtruar nga ankuesja, *në radhë të parë*, Komisioneri do të vlerësojë nëse ajo i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm sa i takon pajisjes me Licencë Ndërmjetësimi, në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesë.

- Lidhur me momentin e aplikimit të datës 15 Dhjetor 2015 dhe mosmarrjes asnjë informacion deri në vitin 2022.

Nga këqyrja e analizimi i pretendimeve, dokumentacionit, si dhe nisur nga kronologjia e ngjarjeve dhe fakteve rezulton se:

Ankuesja shprehet se, me datë 15 Dhjetor të vitit 2015 ka përgatitur dosjen dhe terësinë e dokumentacionit sipas ligjit (të noterizuar) dhe i ka dorëzuar *dorazi* në Zyrën e Protokollit, kati fc -1-rë, pranë Ministrisë së Drejtësisë Tiranë, dhe që nga ajo periudhë e gjer në muajin shtator të vitit 2022, nuk i është kthyer asnjë përgjigje nga ana e Komisionit të Licencave (Komisionit) dhe Ministrisë së Drejtësisë (MD-së).

Pretendimi i ankueses se ka aplikuar për pajisjen me licencën e ndërmjetësuesit që në vitin 2015 rezulton i paprovuar, pasi:

- Pretendimin e saj ankuesja e bazon vetëm në pohimin se në vitin 2015 ka dorëzuar dorazi tek Zyra e Protokollit në MD, kërkesën dhe dokumentacionin përkatës, për pajisjen me Licencën e Ndërmjetësit.
- Ky pohim i njëanshëm, i pambështetur në ndonjë akt tjetër shkresor, dhe i mohuar nga MD, pas kërkimeve në protokollin dhe arkivin e saj, nuk mund të merret në konsideratë, e si i tillë, është i pabazuar ligjërisht.
- Për vertetimin e këtij fakti juridik (dorëzimit të kërkesës dhe dokumentacionit të noterizuar në MD, që në vitin 2015), pohimi i njëanshëm dhe verbal i ankueses është i pamjaftueshëm që të investojë Komisionerin në shqyrtimin e një dokumentacioni, që pretendohet se është dorëzuar që në vitin 2015.

Institucionet shtetërore, administrata publike, por edhe subjektet private, në marrëdhëniet mes tyre, por edhe me shtetasit, individët e interesuar, funksionojnë sipas kuadrit ligjor rregullator - me shkresa që depozitohen e kanalizohen sipas ligjeve në fuqi.

Në këtë kuadër, edhe aplikimet, kërkesat për punë, licenca, leje ushtrimi profesioni, etj, vërtetohen vetëm përmes shkresave, aplikimeve, kërkesave formale të depozituara me postë, në protokollin e institucionit, me dëftesën përkatëse, apo edhe aplikimeve elektronike, në portalet e përcaktuara ligjërisht.

Në këtë kontekst, Komisioneri vëren se, të gjitha pretendimet që burojnë nga veprimet e mosveprimet e Komisionit apo MD-së, lidhen pazgjidhshmërisht me periudhën kur ato supozohet se kanë ndodhur (15.12.2015) ose marrjes dijeni të tyre (duke cituar datën 26.09.2022) dhe përsa i takon të drejtës së kundërshtimit të tyre, ndiqet e drejta e ankimimit brenda afateve të caktuara ligjore.

- Edhe nëse merret e mirëqenë dhe e provuar, se ankuesja ka aplikuar që në vitin 2015 - lidhur me këto momente (dhjetor 2015 dhe shtator 2022) dhe momentin e paraqitjes së ankesës pranë KMD-së, me datë 06.05.2025, Komisioneri vëren se:

Referuar nenit 33, pika 4, shkronja dh), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se: “Ankesa nuk pranohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijeni për sjelljen diskriminuese”, ankesa e shtetasës S. M, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj³.

Pra, konkludojmë së janë tejkaluar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

- Ndërsa, lidhur me pretendimin e ankueses se, Komisioni dhe MD, nuk i janë përgjigjur asaj, që nga data e aplikimit më 15.12.2015 dhe deri më datë 26.09.2022, Komisioneri vlerëson se:

Referuar kësaj periudhe kohore të pretenduar, mosveprimi institucional ka të bëjë me moszbatimin e shkeljen e dispozitave ligjore të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të ndryshuar, dhe kjo kërkesë nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të përcaktuara shprehimisht në dispozitat e ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

³ Për analogji citojmë vendimin nr. 33, datë 07.02.2022, vendimin nr. 22, datë 19.01.2024, vendimin nr. 118, datë 12.05.2025, të KMD-së.

Komisioneri vlerëson se, lidhur me këtë pretendim të ankueses se nuk i është kthyer përgjigje autoriteti mbikëqyrës i pavarur për zbatimin e ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të ndryshuar, është institucioni i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Bazuar në sa më sipër, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, shqyrton kërkesat e personave, të cilët pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre të parashikuara në ligjin 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të ndryshuar.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vëren se, marrja në shqyrtim e pretendimit të ankueses për moskthim përgjigje nga ana e Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësve në MD dhe MD-së, nuk bën pjesë në kompetencat e KMD-së, e për pasojë nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj⁴.

- Lidhur me momentin tjetër të pretenduar nga ankuesja, që ka të bëjë me aplikimin e saj më datë 26.09.2022, me objekt: “Pajisje me Licencë Ndërmjetësimi”.

Nga këqyrja e analizimi i pretendimeve, dokumentacionit, si dhe nisur nga kronologjia e ngjarjeve dhe fakteve rezultojnë se:

- Subjekti ankues ka pohuar se, lidhur me aplikimin e saj me shkresën S-284 Prot., datë 26.09.2022, me objekt: “Pajisje me Licencë Ndërmjetësimi”, drejtuar Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësve/MD dhe MD-së, është vënë në dijeni të veprimeve diskriminuese të pretenduara, nga ana e këtyre subjekteve, kundrejt personit të saj, në datën 30.01.2025⁵, kohë kur dhe pretendon se i është njoftuar vendimi nr. 273/2023, “Për refuzimin e dhënies së Licencës së Ndërmjetësimit”, i Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësimit.
- Në kontekst të sa më sipër, subjekti ankues ka marrë dijeni lidhur me vendimin e refuzimit të dhënies së Licencës së Ndërmjetësimit”, nga Komisioni i Licencimit të Ndërmjetësimit, *(fakt për të cilin dhe pretendon diskriminimin)*, dhe është njohur me aktin përkatës, më datë 30.01.2025, kur i është komunikuar Vendimi. Në rastin në fjalë, marrja dijeni për faktin e pretenduar ka ndodhur më 30.01.2025.
- Ankesa pranë KMD-së është regjistruar në datën 06.05.2025, pra brenda afatit 2 vjeçar nga marrja dijeni e tij.

Për sa më sipër, referuar parashikimeve të LMD-së lidhur afatet ligjore të pranueshmërisë së ankesës pranë KMD-së, ankesa e shtetases S. M, lidhur me momentin kur pretendon se është njohur me veprimet diskriminuese karshi saj (30.01.2025) pranohet dhe për rrjedhojë i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

⁴ Për analogji shih Vendimin nr. 231, datë 25.11.2021 të KMD-së, Vendimin nr. 256, datë 29.12.2021, të KMD-së, Vendimin nr. 167, datë 22.08.2022, të KMD-së.

⁵ Deklarim i ankueses, si dhe bazuar në aktet bashkëlidhur ankesës.

Pra, konkludojmë së janë respektuar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në kontekst të sa më sipër, Komisioneri evidenton se:

Me kërkesën me nr. 01 prot., datë 26.09.2022, me objekt: “Pajisje me Licencë Ndërmjetësimi”, znj. M i është drejtuar Ministrit të Drejtësisë, duke parashtruar ndër të tjera, se: “Referuar Certifikatës për “Trajnim Fillestar për Ndërmjetës”, lëshuar nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësimit (DHKN) me nr. 003 prot., datë 12.11.2015, kam përfunduar me sukses programin e trajnimit dhe të formimit fillestar profesional për ndërmjetës, për periudhën 21 shtator – 17 tetor 2015.

Më datë 15 dhjetor 2015 kam përgatitur dosjen dhe tërësinë e dokumentacionit sipas ligjit (të noterizuar) dhe i kam dorëzuar në Zyrën e Protokollit, pranë MD-së (dorazi).

Që nga ajo periudhë e deri më sot nuk më është kthyer përgjigje sipas ligjit dhe ende nuk jam pajisur me licencë.

Jam interesuar disa herë pranë MD-së dhe DHKN-së, ku kjo e fundit më ka sqaruar se për një periudhë kohore, procesi ka qenë i bllokuar, ndërkohë nga ana e MD-së nuk gjindet asgjëkundi dosja ime.

Aktualisht pas kontakteve me kolegët e mi, jam vënë në dijeni se procedurat për licencim vijoje, fakt për të cilin, të gjithë kolegët e grupit që kanë përfunduar trajnimin me mua, apo kanë aplikuar për licencim, janë pajisur me licencë. Ndodhur në këto kushte, kërkoj nga ana juaj që të konsiderohet fakti i aplikimit që në vitin 2015, duke proceduar më tej sipas ligjit.

Bashkëngjitur kërkesës ju vë në dispozicion CV time, dhe dokumentacionin përkatës aktual, pasi jam në pamundësi objektive të vënies në dispozicion të kërkesës dhe dokumentacionit që kam dorëzuar në vitin 2015.

Shpresoj që kërkesa ime të konsiderohet duke më mundësuar pajisjen me Licencë Ndërmjetësimi, sipas ligjit.”

Në lidhje me këtë moment, Komisioneri konstaton se, ankuesja, kërkesën për pajisjen me Licencë Ndërmjetësimi, e konsideron si vijimësi të aplikimit të vitit 2015, duke kërkuar nga MD, që:

“...të konsiderohet fakti i aplikimit që në vitin 2015, duke proceduar më tej sipas ligjit.”

Me provat e adminsitruara e të shqyrtuara në këtë proces, siç dhe është shpjeguar më sipër, rezulton i paprovuar pretendimi hipotetik i ankueses se ka aplikuar për pajisjen me licencë ndërmjetësi që në vitin 2015.

Ndaj, aplikimi i datës 26.09.2022, konsiderohet dhe është aplikimi i parë e fillestar i ankueses pranë MD-së, për pajisjen me licencë ndërmjetësi.

Në lidhje me këtë aplikim, Komisioni i Licencimit të Ndërmjetësve pranë MD-së, me vendimin nr. 2023-273, datë 02.06.2023, ka vendosur:

“Refuzimin e kërkesë për dhënien e licencës së ndërmjetësimit znj. S. M, për shkak se nuk përmbush kushtet e parashikuara në pikën 3 dhe 9, të VKM nr. 414, datë 08.06.2022 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësve”, ku parashikohet se dokumentacioni i depozituar nga na e kërkesit duhet të jetë i noterizuar. Kundër vendimit të Komisionit mund të bëhet ankim pranë Ministrisë së Drejtësisë brenda 10 (dhjetë) ditësh nga data e njoftimit...”

Ndryshe nga sa pretendon ankuesja, vendimi i mësipërm i KLN-së/MD, është i bazuar në ligj dhe aktet normative përkatëse.

Vetë ankuesja pranon se dokumentacioni i depozituar për pajisjen me licencën e ndërmjetësit, ka qenë fotokopje, pasi ka konsideruar se dokumentacionin e noterizuar e kishte dorëzuar dorazi, në MD, që në vitin 2025, fakt ky që mbetet i paprovuar.

Lidhur me kërkesat dhe dokumentacionin që duhet plotësuar nga personi fizik për licencimin e tij si ndërmjetës, ligji nr. 10385, datë 24.02.2011 *“Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”*, i ndryshuar, parashikon se:

Neni 4 “Licencimi” (ndryshuar me ligjin nr. 26/2018, datë 17.5.2018)

“1. Ndërmjetësi e ushtron veprimtarinë, si person fizik ose si person juridik, pas licencimit dhe regjistrimit të tij në Regjistrin e Ndërmjetësve, sipas këtij ligji.

2. Ndërmjetësi, pas përfundimit me sukses të trajnimit fillestar dhe provimit kualifikues, ka të drejtë të paraqesë dokumentacionin për pajisjen me licencën e ndërmjetësit pranë ministrit të Drejtësisë...”

Neni 6/1-a, përcakton se:

“Ministri i Drejtësisë ushtron detyrat e mëposhtme:

a) Jep licencën e ndërmjetësit;”

Neni 6/1 - Ankimi

“Kundër vendimit për refuzimin e licencës, si dhe urdhrin të ministrit të Drejtësisë për marrjen e masës disiplinore përheqjen e licencës, mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente për çështjet administrative, brenda 45 ditëve nga data e njoftimit...”

Dispozitë kalimtare

“1. Kërkesat për licencim, që janë paraqitur pranë Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësve përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, trajtohen sipas dispozitave në fuqi të ligjit, në kohën e paraqitjes së kërkesës.

2. Komisioni i Licencimit të Ndërmjetësve përfundon veprimtarinë e tij me përfundimin e shqyrtimit të kërkesave të cituara në pikën 1 të këtij neni.”

Në VKM nr. 414, datë 08.06.2011 *“Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësve”*, është përcaktuar në mënyrë të detajuar procedura e licencimit, krijimi dhe mënyra e organizimit të Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësve.

Në pjesën II, pikat 2, 3, e tij, janë përcaktuar dokumentet e nevojshme që duhen paraqitur nga personi fizik, për licencim, si më poshtë citohet:

“2. Kërkesa plotësohet sipas formularit tip, i propozuar nga kryetari dhe i miratuar nga komisioni. Ajo shoqërohet me dokumentet përkatëse, të cilat vërtetojnë përmbushjen e kushteve për ndërmjetës, të parashikuara në ligj, dhe depozitohet pranë komisionit.

3. Dokumentet e nevojshme që duhet të paraqiten nga personi fizik janë këto:

.....

d) diploma e noterizuar, për përfundimin e studimeve të ciklit të parë, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë;

.....”.

Në pjesën IV⁶, të VKM-së, përcaktohet se:

“.....

7. Komisioni merr në shqyrtim kërkesat e regjistruara dhe, pasi verifikon përmbushjen e kushteve të parashikuara në ligj, merr vendim brenda një afati prej 10 (dhjetë) ditësh nga data e paraqitjes së kërkesës. Vendimi i komisionit i njoftohet kërkuarit, me shkrim, pa vonesë. Vendimi i refuzimit përmban, në çdo rast, arsyet e refuzimit të kërkesës për licencë.

....

9. Komisioni e refuzon kërkesën në rast se, edhe pas kalimit të afatit, sipas pikës 7 të këtij kreu:

a) kërkuari, nuk është i autorizuar për të paraqitur kërkesën;

b) formulari i plotësuar nuk është i plotë apo përmban korrigjime dhe përmbajtja e tij nuk duket qartë dhe është e palexueshme;

c) nuk janë paraqitur të gjitha dokumentet e nevojshme, nuk janë paraqitur në formën e kërkuar apo përmbajnë korrigjime ose fshirje të pavërtetuara, sipas dispozitave përkatëse, si dhe kur përmbajtja e tyre nuk duket qartë apo është e palexueshme;

ç) kërkuari nuk përmbush kushtet për ndërmjetës;

d) nuk është kryer pagesa e tarifës së dhënies së licencës.

10. Kundër vendimit të komisionit, kërkuari mund të paraqesin ankim pranë Ministrit të Drejtësisë. Kundër vendimit të Ministrit të Drejtësisë mund të bëhet ankim në gjykatë. Paraqitja dhe shqyrtimi i ankimeve bëhet sipas rregullave dhe afateve të parashikuara në ligj për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative....”.

Bazuar në sa më sipër, u njihet kjo e drejtë të gjithë personave fizikë, kërkuarve për t’u pajisur me licencë ndërjetësimi, konform detyrimit për të paraqitur në çdo rast *dokumentet e nevojshme në formën e kërkuar nga ligji.*

Në këtë kontekst, Komisioneri ka analizuar se cilat shkresa konsiderohen *dokument ligjor*, sipas përcaktimeve ligjore përkatëse.

⁶ Rregullat për funksionimin e Komisionit.

Ligji nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në kreun VIII “Shkresat” ka përcaktuar respektivisht si më poshtë citohet:

Neni 246 “Fuqia provuese e shkresave” ka parashikuar se: “Shkresat kanë fuqi provuese kur janë hartuar në formën e caktuar, kanë elementet e nevojshme për vlerën e tyre, nuk janë të copëtuara, të grisura ose...”.

Neni 251 “Kopja e shkresës dhe origjinale i saj”, i tij, ka parashikuar se: “Kopjet e shkresave kur saktësia e tyre vërtetohet nga personi kompetent kanë të njëjtën fuqi provuese me origjinalin”.

Ligji nr. 110/2018 “Për noterinë”, në nenin 3/c) të tij, ka përcaktuar se: ““Noter” është personi fizik i licencuar nga ministri i Drejtësisë për kryerjen e veprimtarisë noteriale brenda territorit të një bashkie të caktuar, në përputhje me dispozitat e këtij ligji”.

Në Kreun V të këtij ligji, janë përcaktuar kompetencat, të drejtat, përgjegjësitë dhe detyrat e noterit. Kështu, neni 62, pika 1/i, e tij ka parashikuar se: “Noteri, përveç kompetencave të parashikuara në ligje të veçanta, harton akte, kryen njësimë, vërtetime dhe verifikime në të gjitha çështjet, duke përfshirë, por pa u kufizuar:

.....

i) vërteton se kopjet ose versionet e shkurtuara të dokumenteve janë të njëjta me origjinalin e paraqitur nga palët e interesuara”

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, ligji ka mirëpërcaktuar se cilat shkresa konsiderohen si dokument ligjor, mënyrën e hartimit apo njësimin të tyre si dhe autoritetin përgjegjës i cili gëzon ligjërisht këto kompetenca.

Për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson se, pretendimi i subjektit ankues që, dokumentet e dërguara në fotokopje, në aplikimin e datës 26.09.2022, me arsyetimin se i ka depozituar dorazi, më datë 15.12.2015, dokumentet origjinale, dhe se ato duhet të konsiderohen e të njihen si dokumente provues të ligjshme; nuk qëndron pasi është i pabazuar ligjërisht.

Në këto kushte, vendimi i refuzimit të licencimit për ndërmjetës, për ankuesen, ka ndjekur procedurat dhe arsyetimin ligjor, ndaj pretendimi i saj se është diskriminuar për shkak të shfaqjes së bindjeve të saj politike dhe kritikave për të metat e problematikat e qeverisë aktuale, nuk qëndrojnë, përderisa dokumentacioni i saj i aplikimit për licencë paraqitet me mangësi.

Për më tepër, rezulton se edhe për subjekte të tjera, ndodhur në kushte të njëjta me të ankueses, nga ana e Komisionit është vepruar po njëjllë, duke refuzuar miratimin e licences se ndërmjetësit, pasi dokumentacioni i depozituar prej tyre ishte fotokopje.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson të drejtë kërkesën e KLN/MD-së drejtuar ankueses, lidhur me detyrimin e saj si subjekt fizik që aplikon për t’u pajisur me licencë ndërmjetësi, për të paraqitur

dokumentacionin original, ose fotokopjen e noterizuar të tyre, si dokumente të vlefshëm sipas përcaktimeve specifike ligjore.

Në analizë të sa më sipër, Komisioneri gjykon se ankuesja, nuk është ekspozuar ndaj një qëndrimi të padrejtë, pabarabartë e pafavorshëm, nga ana e Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësve/MD.

Në këtë kuptim dhe në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se subjekti ankues nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e subjekteve kundrejt të cilave është ankuar pranë KMD-së.

Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese kundrejt ankueses, ardhur për shkak të bindjeve politike.

- Lidhur me pretendimin e ankueses se, për vendimin e refuzimit të licencimit është vënë në dijeni me vonesë, me datë 30.01.2025 (për shkak se kishte ndërruar adresë), Komisioneri vëren se:

Rezulton se, me shkresën me nr. S-165/1 Prot., datë 07.06.2023, me lëndë: “Njoftim vendimi”, Komisioni i Licencimit të Ndërmjetësve/MD, i ka njoftuar znj. M vendimin e refuzimit të Komisionit. Adresa në të cilën është dërguar kjo shkresë, është, adresa në faqen e parë të aplikimit të znj. M.

MD, ka informuar se, nga verifikimet e kryera prej tyre, nga sektori aktual përkatës pranë Ministrisë së Drejtësisë, si dhe nga verifikimi i kryer në sektorin e Arkiv-Protokollit, ka rezultuar se zarfi me të cilën është dërguar kjo shkresë ka mbërritur në destinacionin e dërguar, pra ka pasur një marrës.

Znj. M pretendon se ka ndryshuar adresën dhe nuk e ka marrë zarfin. Por, nga ana tjetër, nuk ka informuar MD-në për ndryshimin e adresës.

Për sa më sipër, Komisioneri vëren se, ndodhur në kushtet kur shkresa përcjellëse dalëse me refuzimin e vendimit, pra vijimi i komunikimit është në adresën e vendosur nga vetë ankuesja si dhe në kushtet kur ajo nuk ka njoftuar apo lajmëruar KLN/MD apo MD-në, për ndryshim adrese, ankuesja nuk mund të pretendojë për moslajmërim të vendimit në adresën e saj për faj të Komisionit, pasi ajo do të duhet t’ia kishte komunikuar paraprakisht ndryshimin e adresës.

Nëse ankuesja ka pretendime për pavlefshmëri të njoftimit, ky është një kërkim që i nënshtrohet gjykimit administrative, në rrugë gjyqësore.

- Lidhur me pretendimin për moskthimin e përgjigjes nga Ministri i Drejtësisë, mosinformim lidhur me ankimimin e saj kundër KLN/.MD-së.

Ky kërkim i znj. S. M, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj nga KMD, pasi Komisioneri

vëren se, ky kërkim i ankueses ka të bëjë me moszbatimin apo shkeljet e dispozitave ligjore të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të ndryshuar, sa i takon pretendimit të saj për mosdhënie të informacionit të kërkuar.

- Lidhur me pretendimin për shkelje të detyrimit për të dalë me me akt administrativ, lidhur me ankimimin e saj kundër KLN/.MD-së, nga ana e Ministrit të Drejtësisë, Komisioneri vëren se:

Ligji nr. 10385, datë 24.02.2011 “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”, i ndryshuar, në nenin 6/1⁷, të tij, parashikon se: “Kundër vendimit për refuzimin e licencës, si dhe urdhrin të ministrit të Drejtësisë për marrjen e masës disiplinore përheqjen e licencës, mund të bëhet ankimi në gjykatën kompetente për çështjet administrative, brenda 45 ditëve nga data e njoftimit.”

Kodi i Procedurës Administrative, në nenin 97⁸, përcakton se: “1. Nëse pala ka kërkuar në procedurën administrative nxjerrjen e një akti administrativ shkresor dhe organi publik nuk njofton vendimin brenda afatit të përcaktuar me ligj apo akt nënligjor për përfundimin e procedurës dhe nuk njofton zgjatjen e afatit ose nuk njofton vendimin brenda afatit të zgjatur, kërkesa konsiderohet si e miratuar dhe akti administrativ shkresor i kërkuar si i miratuar në heshtje (akti në heshtje) në rastet kur është parashikuar nga ligje të veçanta.

2. Pala ka të drejtë të kërkojë nga autoriteti publik, i cili nuk ka nxjerrë aktin administrativ të kërkuar, një konfirmim me shkrim se kërkesa e saj konsiderohet të jetë miratuar në përputhje me pikën 1 të këtij neni. Konfirmimi përmban tekstin e kërkesës, datën e paraqitjes së saj dhe faktin që organi publik nuk ka njoftuar vendimin e tij brenda afatit të përcaktuar sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Nëse autoriteti nuk nxjerr një konfirmim në përputhje me pikën 2, të këtij neni, brenda 7 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës së palës sipas pikës 2, të këtij neni, ose në të njëjtën kohë nuk nxjerr aktin administrativ të kërkuar, pala mund të ngrejë padi në gjykatën kompetente për çështjet administrative, për të saktësuar të drejtat dhe detyrimet ndërmjet paditësit dhe organit publik.”

Për rrjedhojë, për sa më sipër, ankuesja mund t’i drejtohet institucionit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, pasi hetimi sa më sipër nuk bën pjesë në kompetencat e KMD-së⁹.

Pra, konkludojmë se nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

⁷ Ankimi

⁸ Miratimi në heshtje

⁹ Për analogji shih vendimin nr. 167, datë 22.08.2022 dhe vendimin nr.175, datë 05.08.2025, të KMD-së.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar,
Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjektit ankues, S. M, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësimit, pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Minsitrit të Drejtësisë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA